

ABU SEMAN
K. B. Bot. 417
Dt 24/07/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 4 Datë 21/06/2018

Per dhenien e opinionit per prioritetin të burimit ujore te perrenjeve Kamicanit dhe te Bistes, dege te lumit Holtes dhe e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie në Bashkia Elbasan qarku Elbasan

Në mbështetje te ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave "Per miratimin e kushteve te pergjitheshme e te posacme, dokumentave shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formularve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore". Vendimit te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujore"
Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Dhenjen e opinionit per prioritetin të burimit ujore te perrenjeve Kamicanit dhe te Bistes, dege te lumit Holtes dhe e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie në Bashkia Elbasan qarku Elbasan

Vepra e marrjes Nr1

X=44 41 046 Y=45 38 708 Z=800 m

- Prurja mesatare 0.39 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.52 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.06 m³/sek.

Vepra e marrjes Nr2

X=44 40 828 Y=45 39 005 Z=800 m

- Prurja mesatare 0.1 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 0.14 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.015 m³/sek.

Godina e centralit

X=44 38 899 Y=45 34 194 Z=473 m

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 1860 kW

Per perdorimin e ketij burimi ujqor duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbattoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.